



---

**RREGULLORE NR. 2003/19**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS  
MBI BIBLIOTEKAT**

**Neni 22**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës**

22.3.1. është qendër e marrjes dhe e depozitimit të kopjes së detyrueshme;

**Neni 30**

30.1. Materiali bibliotekar burimor (dorëshkrime, i shtypur ose i krijuar në ndonjë formë tjetër), që ka vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën, (libri i rrallë apo unikat, materiali i vjetër, kopia e detyrueshme e publikacionit), sistemohet në koleksion të trashëgimisë dokumentare kulturore dhe konsiderohet pjesë e thesarit kulturor kombëtar; ruhet e mbrohet në përputhje me dispozita të veçanta që vlejné për trashëgiminë kulturore; shfrytëzohet vetëm në mjediset e bibliotekës, përkatësisht nuk jepet në huazim.

## KREU IX

### DISPOZITA TJERA

#### Neni 39

39.1. Çdo person ose subjekt që boton publikacione në Kosovë që i dedikohen shfrytëzimit publik, detyrohet që pesë kopje të çdo botimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit; e nëse botuesi nuk është i identifikuar ose është i identifikuar rrejshëm (i panjohur), përkatësisht nuk ka vendqëndrim ose seli në Kosovë, këtë detyrim do ta kryejë shtypshkronja, përkatësisht subjekti që ka bërë riprodhimin.

39.2. Si botim konsiderohen librat si dhe librat me disk gramafoni, me kasete audiovizuale, me harte gjeografike e shtojca të ngjashme (botimet multimediale), broshurat, separatet, revistat, gazetat, riprodhimet artistike, veprat muzikore të shkruara në partitura, hartat gjeografike, atlasat, globuset e të gjitha llojeve, planet urbanistike, pllakatat, katalogjet, programet, kartolinat dhe fotografitë e shtypura, diapozitivat etj. si dhe pjesët e tyre përbërese a shoqëruese të riprodhuara në mënyrë grafike, disqet e gramafonit dhe kompakt disqet, kasetat audio dhe vizuale të regjistruara, disketat kompjuterike të regjistruara dhe veprat tjera që riprodhohen me shtypshkrim ose në një mënyrë tjetër të ngjashme.

#### Neni 40

41.3.Me gjobë prej 200 - 1000 € dënohet për kundërvajtje botuesi, përkatësisht subjekti që nuk kryen obligimin e dërgimit të kopjes së detyrueshme në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ( neni 39.1.);